



KONTRATË

Numri i kontratës:¹ **616-22-10564-5-1-1/C1252**

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

K.N.P.SH. PAPENBURG & ADRIANI COMPANY SH.P.K., Grackë e Vjetër, Magjistrale M- 25 Ibrahim Rugova , Pn, Lipjan, (ne vazhdim "Kontraktuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për pune e shënuara me poshtë:

Intervenime infrastrukturore në territorin e Komunës së Prishtinës me numër identifikues: **616-22-10564-5-1-1**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Intervenime infrastrukturore në territorin e Komunës së Prishtinës - lot 1 Intervenime infrastrukturore në territorin e Komunës së Prishtinës - lot 2 Intervenime infrastrukturore në territorin e Komunës së Prishtinës - lot 3 Intervenime infrastrukturore në territorin e Komunës së Prishtinës - lot 4 Intervenime infrastrukturore në territorin e Komunës së Prishtinës - lot 5 Intervenime infrastrukturore në territorin e Komunës së Prishtinës - lot 6**

No.	Lot
6	Intervenime infrastrukturore në territorin e Komunës së Prishtinës - Lot 6

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i kontratës është: **300.000,00 €**. Çmimi total i peshimit i punëve duhet të jetë: **31.76 €**;

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknikë;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

(Procesverbal i mbledhjes informative/vizitës se vendit)

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

[shëno çdo dispozitë tjeter të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4

Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjeter duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvèç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" "ose" vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrëthanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën 2 në tri originale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

AUTORITETI KONTRAKTUES		OPERATORI EKONOMIK	
Emri:	Visar Shehu	Emri:	Hilmi Dërcili
Pozita:	U.D. Departamenti i Prokurimit	Pozita:	Drejtør
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	31.07.2023	Data:	31.07.2023
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 616-22-10564-5-1-1/C1252

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhineringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grapi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Cmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruara dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontaktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4**Nën-kontraktimi**

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertës. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontratës, Kontraktuesi duhet te rjoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e rjoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkizati me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES**Neni 5****Dhënia e dokumenteve**

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë ne dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6**Qasja në vend punishte**

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me securinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit ne vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrate të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjate shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërcohët nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre originale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7**Ndihma lidhur me rregulloret vendore**

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhërët apo ligjet anësore të Republikës se Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kerkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu eksposuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grüpuit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritet nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identikuara në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVKG. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit te Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianeve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianeve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit te tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguaruar humbjen apo dëmet e pësuara.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsyet e mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose te eliminojë sigurimin dhe të zbrsesë çmimin e shpërbllimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës se specifikuar ne KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do te përmbate se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor qe kërkohet për dorëzim dhe miratim te vizatimeve, metodat e përgjithshme qe do ti zbatoje, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për me tepër kërkon modifikime ne programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnojoj Programin në intervalle jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitura e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëloj ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndaloj qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve te Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahan. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë te cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrate ose që me arsyet mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet ne peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë te veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet ne shpenzime të Kontraktuesit, pa marre parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit te shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 **Tatimi**

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 **Kostoja e Riparimeve**

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigimit të Defekteve do të irregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 **Fillimi i punëve**

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 18 **Zgjatja e periudhës së ekzekutimit**

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsyet:

- Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkësë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjeter ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit te detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do ti lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospективë ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 **Dëmet e likuiduara**

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zgres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

MATERIALET DHE MJSHTËRITË

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përvèç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

kushtet e motit, ndërprerjet e punës qe detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rr Ethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhëne Kontraktuesit;

deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave qe duhet bere Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune ne progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar te dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon qe të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marr një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkësës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të janë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkësat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të janë objekt i një kërkese të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet ti referohet numrit te kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do te zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuara në kërkësë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkësat për këtë pranim para se të inkorporohen në pune.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në pune ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në pune vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj “Menaxherin e Projektit”, të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet te dorëzohen në kohë në vend për ti lejuar autoritetit kontraktues qe të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do ti lejohet që të paraqesë ndonjë arsyë përvonesë në përbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agentit e tij, qe të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo

prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishte ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do te miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes se mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kérkon, nga një ekspert qe zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilat dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato ne skica apo ne specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët ne kontrate vlerësojnë se ndërrimet substanciale te punëve janë bere te nevojshme për shkak te gabimeve te tillë ose te përjashtimeve te cilat substancialisht ndikojnë ne çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do te korrigojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit te Prokurimin Publik.

PAGESAT

Neni 24 Pagesa

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikatë. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhen nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 25 Paramasa dhe Paralogaria

25.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve qe duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbaj aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garacioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të

pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmoj se pagesa paradhënësës është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim e tërë të Punëve. Kjo shume ne asnjë rast nuk do te tejkaloj 10% e vlerës totale te kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garacion bankar "me kërkesë".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose
- Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëj vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft te deklaratës se llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës se llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- Shumen e cila sipas opinionit te tij duhet ti paguhet sipas kontratës; dhe
- pas evidentimit te shumave te paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund te jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshoje te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumen përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVËK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsyte të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi te jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa te jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përvëç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontraten dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinnovimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinnovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesëshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinnovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendor, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjeter për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto te Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë se defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë se defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë se defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektit apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe te jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- dëmet; dhe/ose
- ndërpërjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e konratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Konratës.

37.2 Shkelja themelore e konratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërprenë punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërpërje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsyet e justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigimi i defekteve është shkelje e konratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e konratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të konratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e konratës paraqet bazë për shkëputje të konratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijuhen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të konratës, Menaxheri i Projektit me pëlgimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet t'i paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërpërje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Ne rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcen Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësive të parapara me konratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimet të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritë nga dita e ngjarjes që përcakton Forcen Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përbushura në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të konratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcen Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me konratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërpërjen e konratës.

Neni 39**Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40**Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41**Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësitet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjeter jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**Neni 42****Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkësës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkësës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- ose vendim nga gjyqi;
- kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 616-22-10564-5-1-1/C1252

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>	<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>	
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Neni. Nr.</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 90,000.00 EUR . Në validitet prej 13 muajsh
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 15 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurmuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit te kërkesës se Menaxherit te projektit .
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 15 dite pas nënshkrimit te kontratës
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: 12 muaj
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Registri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi testimi dhe	22.1	Menaxheri i Projektit është: do te përcaktohet pas nënshkrimit te kontratës me vendim nga ZKA
Parimet e përgjithshme pagesave	24	Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacione në vlera minimale për punët e kryera dhe te konstatuara nga menaxheri i kontratës.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagesë paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës se kontratës . Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 te KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

Shkaqet përkompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Komerciale - Prishtinë

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

INTERVENIME INFRASTRUKTURORE NE TERRITORIN E KOMUNES SE PRISHTINES- NE FSHATRA

Nr.	Përshkimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH(€)	Çmimi njësi me poentim Total (€)	poentimi
PUNËT PËRGATITORE						
1	Mobilizimi i ndermarrjes per fillimin e punimeve. Punimi detali i planit dinamik per realizimin e punimeve duke perfshire ditel e punes, mekanizmin dhe fuqine pune. Ndërtimi i punishtes që përfshinë: a) Zyra e përkohshme e ndërmarrjes më së paku 2 ndarje, secila ndarje duhet të ketë së paku sipërfaqe S=12m ² , me një sanitare si dhe e kyçur në furnizimin me energji të pandërprerë elektrike dhë të ujtit. Zyra duhet të ketë lidhje në kanalizimin publik funksional ose në një rezervuar ekologjik mobil b) Zyra për organin mbikqyrës (minimum S=12m ²), një tavolinë pune me minimum 5 karriga pune për gjatë gjithë kohës së ndërtimit c) ekologjike mobile për statin punues ekzekutiv për gjatë gjithë kohës së ndërtimit d) Furnizimi i zyrës me lidhje për komunikim: telefon, faks dhe internet për gjatë gjithë kohës së ndërtimit. OE është i obliguar që të monitorojë gjendjen e zones 24h dhe të jetë i pregatitur që në momentin e paraqitjes së nevojës për intervenime në troiare,grupe në rrugë,kapakë të pusetaue,ujmbledhësa e dëmtime të tjera të marrë masa të menjëherëshme për sanim.OE duhet të sigurojë deponi për deponimin e materialeve të nevojshme dhë makinerinë në një largësi jo më të madhe se 2 km nga zona.	paushall	1.00	50	0.25	0.5
1.1	Të sigurohet punishtja, të ndërrmireni masat e sigurise sipas ligjeve ne fuqi, te vendosen shenjat e njosimit per punime ne rruge, te ruhet ambienti konform ligjeve ne fuqi, qe gjate ndërtimit te mos vies tek degradimi I ambientit.	paushall	1.00	50	0.25	0.5
1.2	Ekzaminimi i materialeve para dje pas vunjës në vepr (atestet Paraprake dhe Kontrolluese te asfaltit , gureve skajore, kubezave,zhavorit, kapakëve dhe materialeve tjera që perdoren per ndërtim). Kontraktori është i obliguar që të sjellë ateste paraprake dhe prejardhjen e materialit para fillimit të punimeve si dhe shqyrtimet nga instituti i licencuar per shqyrtimin e materialeve ndërtimore.	paushall	1.00	50	0.25	0.5
Gjithesejt:						0.75
1.5						
PUNËT E DHEUT dhe te DEMOLIMIT						
2.1	Gjurmimi i kombinuar i dhet te kategorise III dhe V (50+50,me makina dhe me dorë),ngarkimi dhe transporti i dhet ne deponi ne distancë 15km.	m ³	1.00	12	0.6	5
2.2	Furnizimi, transporti, mbjellja dhe mirëmbajtja e gjelberimit- barit (Italian,Anglez dhe Sloven) deri ne stabilitetin dhe qëndrueshmérin e duhur për zhvilim me dendësi 30-40 gr/m ² ose sipas udhëzimit të prodhuesit si dhe furnizimi i dhe mbulimin me një shtrës te imet dhei pas mbjelljes, rrafshimin me njëshje me cilindër të dorës/kopshtarit prej 50-60 kg,duke përfshirë ujijen dhe kositjen deri ne përfundimin e kontratës .	m ²	1.00	30.00	0.15	0.5
2.3	Demolimi i shyllave të metalit,drurit dhe betonit me diametër Ø të ndryshme,ruajtja e tyre në deponi, si dhe pas përfundimit të trouareve montimi i tyre.	cope	1.00	150	0.3	0.2
2.4	Demolimi i shenjave të komunikacionit,ruajtja e tyre në deponi,pas përfundimit të trouareve dñe rrugëve montimi i tyre.	cope	1.00	30	0.03	0.1
2.5	Demolimi me dorë i rigollave të betonit me gjërsi të ndryshme cm, trashësi (=10cm ngarkimi dhe transporli deri ne deponi të qyteti .	m'	1.00	20	0.02	0.1
2.6	Demolimi me dorë i kubzave të guri me dim. 10x10x10cm, kubzat duhet të palohen ne afersi te punishtes,pas stabilizimit te trasës së rruges duhet te montohen. Në çmimin te illogaritet eshte rëra e imët për montimin e kubzave ,mbushja e fugave dhe njëshja	m ²	1.00	40	0.4	1
2.7	Demolimi me dorë,ngritja e skajoreve eksistues ne nivelin e duhur dhe punimi i fugave me llaq te qimentos 1:2.	m'	1.00	10	0.02	0.2
2.8	Demontimi i rrëthojave nga teli me gjemba, rrëthojave metalike, rrëthojave metalike me cokell betoni si dhe rrëthojave prej mureve,demontimi i reklanave dhe rivendosja e tyre aty ku ka mundësi, shkallevet me largim dhe bartje deri ne deponi.	m'	1.00	25	0.125	0.5
2.9	Demolimi i shkallëve, mureve prej betonarmësë, plakave me trashësi 60cm, ngarkimi, transporti dñe shkarkimi i materialit te demoluar ne deponi.	m'	1.00	50	0.5	1



2.10	Demoliimi i skajoreve 8/20/100 cm me dorë (ose eskavator), që mos të vie deri te dëmtimi i shtrësës së asfaltit ekzistues, ngarkimi, transporti dhe shkarkimi i materialit të demoluar në deponi.	m'	1.00	5	0.05	1
2.11	Demoliimi i skajoreve 18/24/100 çm me dorë (ose eskavator), që mos të vie deri te dëmtimi i shtrësës së asfaltit ekzistues, ngarkimi, transporti dhe shkarkimi i materialit të demoluar në deponi.	m'	1.00	10	0.01	0.1
2.12	Hapja e kanaleve të ujërave atmosferike duke perfshir: hapjen dhe formsimin e tyre.	m'	1.00	10.00	0.01	0.1
2.13	Pastrimi i kanaleve të ujërave atmosferike duke perfshir: hapjen dhe formsimin e tyre.	m'	1.00	10.00	0.1	1
2.14	Furnizimi, transporti dhe punimi i lëshesave monolite ose montazhe nga betoni i armuar me koka hyrëse-dalëse, punimi komplekt (kryqezimet me rruge lidhese) Ø 500 mm.	m'	1.00	20.00	0.2	1
2.15	Furnizimi, transporti dhe punimi i lëshesave monolite ose montazhe nga betoni i armuar me koka hyrëse-dalëse, punimi komplekt (kryqezimet me rruge lidhese) Ø 800 mm.	m'	1.00	35.00	0.35	1
2.16	Furnizimi, transporti dhe punimi i lëshesave monolite ose montazhe nga betoni i armuar me koka hyrëse-dalëse, punimi komplekt (kryqezimet me rruge lidhese) Ø 1000 mm.	m'	1.00	55.00	0.55	1
2.17	Debllokimi dhë pastrimi i lëshesave monolite ose montazhe nga betoni i armuar me koka hyrëse-dalëse (kryqezimet me rruge lidhese) Ø 500 mm deri Ø 1000 mm nga materialet e ngurta dhe të gjitha materialet tjera.	m'	1.00	10.00	0.1	1
2.18	Sjellja, shpërndarja, planifikimi dhe kompaktësimi i shtrësës humusore (mbushje humusi) me trashësi prej 20 cm për përshtatjen e terenit per mbjelljen e barit të ri adekuat.	m²	1.00	10.00	0.01	0.1

Gjithesejt: **3.53** **14.9**

III	PUNËT E RIPARIMEVE ME ASFALT				
3.1	Përgatitje e gropave të tipit T1, me AB11, trashesi d=4cm ne gjendje te ngjeshur. Në çmim duhet llogaritur: prerja, demoliimi, transporti i materialit te demoluar, lyra me emulzion, furnizimi, transportimi dhe vuaria në vepër të AB11. E gjitha kjo sipas rregullave teknike per keto punime. (Shih edhe kushtet e vecanta dhe skicën)	m²	1.00	17.5	0.88
3.2	Përgatitja e gropave te tipit T2 trashesic d=12cm.Ne çmim duhet llogaritur: prerja, demoliimi, transporti i materialit te demoluar, lyra me emulzion, furnizimin,transportimin dhe vuaria në vepër e shtresave BZH22 (8 cm) dhe AB11(4cm). E gjitha kjo sipas rregullave teknike per keto punime. (Shih edhe kushtet e vecanta dhe skicën)	m²	1.00	28	1.40
3.3	Përgatitja e gropave te tipit T2 trashesic d=18cm.Ne çmim duhet llogaritur: prerja, demoliimi, transporti i materialit te demoluar, lyra me emulzion, furnizimin,transportimin dhe vuaria në vepër e shtresave BZH22 (8+6) cm dhe AB11(4cm). E gjitha kjo sipas rregullave teknike per keto punime. (Shih edhe kushtet e vecanta dhe skicën)	m²	1.00	30	1.50
3.4	Pergatitja e gropave T2 deri ne shtresen e shendosë d=32cm. (kjo vlen ne ato raste ku deformimet jan ne bazamentin e rruges). Ne çmim duhet llogaritur: prerja, demoliimi, transporti i materialit te demoluar, lyra me emulzion, furnizimin,transportimin dhe vuaria në vepër e shtresave materialit bazë gurë i thyer (0-31.5 mm), në trashesi d=20 cm dhe ngjeshja, BZH 22 me d=8 cm, ngjeshja dhe shtresa AB11 d=4cm prap ngjeshja. E gjitha kjo sipas rregullave teknike per keto punime. (Shih edhe kushtet e vecanta dhe skicën)	m²	1.00	30	0.90
3.5	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e asfaltit të ftohtë për sanimë të gropave emergjente-shif specifikimt dhe skicat.	m²	1.00	20	0.40
3.6	Punimi i shtresës se re qarkulluese prej AB11 trashesie d=4cm me gryerje dhe lyre me emulsion. Në çmim duhet llogaritur furnizimin, transportimin dhe punimin e AB, gryerjen dhe lyerjen me emulsion. Organë mbikqyrës duhet ta caktoje granulimin e asfaltit varesishë nga gjendja ekzistuese ne teren, pjerrësia, kushtet klimatike etj.	m²	1.00	15	1.05
3.7	Punimi i shtresës se re qarkulluese prej AB16, trashesie d=7cm me gryerje dhe lyre me emulsion. Në çmim duhet llogaritur furnizimin, transportimin dhe punimin e AB, gryerjen dhe lyerjen me emulsion. Organë mbikqyrës duhet ta caktoje granulimin e asfaltit varesishë nga gjendja ekzistuese ne teren, pjerrësia, kushtet klimatike etj.	m²	1.00	15	0.45



3.8	Punimi i shtreses se re qarkulluese prej BZH 22 , trashesic d=7cm me gryerje dhe lyre me emulsion. Në çmim duhet illogaritur furnizimin, transportin dhe punimin e BZH, gryerjen dhe lyerjen me emulsion.Organi mbikqyrës duhet ta caktoje granulinin e asfaltit varesisht nga gjendja ekzistuese ne teren, pjerrësia, kushtet klimatike etj.	m ²		13	0.52	4
3.9	Punimi i shtreses me asfalt beton ne trotuar prej AB8 , trashesi d=4cm. Në çmim duhet illogaritur: prera, demolimi, transporti i materialit te demoluar, lyra me emulsion, si dhe furnizimin - punimin sipas irregullave teknike per keto punime	m ²	1.00	15	0.15	1
3.10	Punimi i shtreses me asfalt beton ne trotuar prej AB11, trashesi d=4cm. Në çmim duhet illogaritur: prera, demolimi, transporti i materialit te demoluar, lyra me emulsion, si dhe furnizimin - punimin sipas irregullave teknike per keto punime	m ²	1.00	15	0.15	1
3.11	Filer i lengët (Liquid Crackfiller) kuarc 0-2mm, bitumen I nxehët per mbushjen e plasarijeve me gjëresi dhe thellesi deri ne 2 cm.	m ²	1.00	10	0.01	0.1
3.12	Sanimi i shtresave nga gomia me trashesi 1.5-2.5 cm ne pjesët ku eshtë i nevojshe interventimi sipas kërkesave per sanim ne vendet e përcaktuara nga organi mbikqyrës. Sanimi përfshinë: 1.Gerryera,pastrimi i pluhurit,mbushja e gropzave eventuale etj. 2. Shtrirja e primerit Poloplast P10 me baze poliuretan ne trashesi 1.0 mm. 3. Vendasja e gomes se bluar SBR me granulacion 1-4 mm e cila perzihet me ngjites poliuretan Poloplast P 13, trashesi 13-25 mm (varesisht nga trashesa e shtresave ekzistuese te gomes ku eshtë i nevojshe sanimi) 4. Shtrirja behet me makine speciale (finisher). 5. Shtrirja e poliuretanit dy komponentesh Poloplast P12 me ngjyre dhe granulave te gomes me ngjyre EPDM ne trashesi rreth 2.0 mm. Shtrirja behet me makine me sperkatje (spraycoat). 6. Planifikimi dhe ngjyrosja e vijave me PU Line marking ne pjesën ku behet sanimi.	m ²	1.00	40	0.40	1
3.13	Demolimi me dorë,ngritura e skajoreve ekzistues ne nivelin e duhur dhe punimi i fugave me llaq te qimentos 1.2.	m'	1.00	10	0.10	1
3.14	Inçizimimet gjodezike ngainxhimi gjedjet ku përfshihen matja e sipërfinqeve te asfaltit, pllakave dhe pozicioneve tjera që maten me m ² , sipas kërkesës së organizit mbikqyrës ne pjesët ku kemi intervenime.	m ²	1.00	8	0.24	3
	Gjithesejt:				8.15	41.1
IV.	PUNËT E TAMPONIT- RIPARIMEVE ME PLLAKA TE BETONIT					
4.1	Furnizimi, transporti, planifikimi dhe punimi i materialit guror fraksion (0-100) mm, materiali duhet te jetë i paster pa primesa te dheut sipas standardeve dhe kushtetive teknike, ne pikat ku kemi deformime te medha te trupit te rruges.	m ³	1.00	14	0.14	1
4.2	Furnizimi, transporti, planifikimi dhe punimi i materialit guror fraksion (0-60) mm, materiali duhet te jetë i paster pa primesa te dheut sipas standardeve dhe kushtetive teknike, ne pikat ku kemi deformime te medha te trupit te rruges.	m ³	1.00	16	0.24	1.5
4.3	Furnizimi,transportimi,planifikimi dhe punimi i materialit guror fraksion (0-31.5) mm,materiali duhet te jetë i paster pa primesa te dheut sipas standardeve dhe kushtetive teknike, ne pikat ku kemi deformime te medha te trupit te rruges	m ³	1.00	16	0.24	1.5
4.4	Furnizimi, transportimi, planifikimi i materialit fraksion (0-2)mm mbi pllakat ekzistuese te betonit ne trotuar, ne ato vende ku ka nevoj fugimi i pllakave. Aty ku perekton organi mbikqyres. Në çmim duhet illogaritur edhe ngjeshjen e pllakave te betonit pas hudhies stë rrëres.	m ³	1.00	16	0.16	1
4.5	Demolimi i kubzave dhe shtresave tjera mbajse deri ne koten e germimit egzistues me qellim te sanimit te konstruksionit te shtresave mbajtese. Pregadija, furnizimi dhe shtrimi i zhavorit ne trashesi 35cm, ngjeshja e tije , si dhe planifikimi dhe kthimi i kubzave te vjetra ne pjeset e deformuara, ne rruge dhe trotuar. Kjo nenkupton edhe rercen e imet 0-2 mm per mbushjen e fugave te kubëzave e gjiztuese, si dhe ngjeshja e tyre.	m ²	1.00	16	0.16	1
4.6	Furnizimi,transporti dhe montimi i kubzit te granitit me dim.10x10x10cm,ne çmim te illogaritet edhe rera e imet per montim me trashesi 5cm ,mbushja e fugave dhe ngjeshja.	m ²	1.00	150	1.50	1

KOMODATATE NOVATIMORE PRODHUESI DHE SHERBUESI
PAPENBURG ADRIANI COMPANY SHK.
Gruka e Vjetër
LIPJAN * 7 * ASTRA

4.7	Furnizimi, transportimi dhe montimi i kubëzave të betonit C30/37 (me trashesi 8cm) në rrugë dhe trotuar ku përcakton organi mbikqyres. Ne cimim te llogaritet: tamponi fraksioni 0-60mm me trashesi prej 25 cm ne gjendje te ngjeshur, tamponi fraksioni 0-31mm me trashesi prej 10 cm ne gjendje te ngjeshur, rëra nen kubëza fraksioni 2-5mm me trashesi 5cm, kubzat e betonit me trashesi 8 cm, rëra e imet 0-2mm per mbushjen e fugave te kubëzave, si dhe ngjeshja e kubëzave. Kjo nenkupton edhe largimin e kubëzave te dëmtuara deri ne deponi. Formen, ngjyrën dhe modelin e kubëzave e përcakton organi mbikqyres.	m ²	1.00	22	0.66	3
4.8	Pastrimi,larja ,furnizimi dhe montimi i pllakave të betonit me trashesi 3cm (teracer)për mveshjen e shkallëve të betonit duke llogaritur edhe llaçin e cementos 1:1.	m ²	1.00	35	0.18	0.5
4.9	Furnizimi dhe betonimi me Beton Arme C30/37(Ø8, Ø10, Ø12, varesisht nga nevoja) e mureve mbajtse te rruges dhe trotuareve, pllatove, shkalleve, hyrjeve etj. Ne cimim te llogaritet pahite e nevojsime, kallepimi dhe njomja e betonit me uje se paku 12 ore pas betonimit. (per 1 m ³ beton nevoiten 80 kg armature).	m ³	1.00	200	2.00	1
	Gjithesejt				5.28	11.5
V	PUNET E SKAJOREVE DHE GARDHIT SIGURUES PER KËMBESOR					
5.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i gurëve skajor C30/37 ($T>5.0 \text{ N/mm}^2$) të përhimet në bazen e betonit, dim. 18/24, punimi i fugave me llaq te cimentos 1:2. Menyra e vendosjes se tyre caktohet nga organi mbikqyres.	m'	1.00	14	0.28	2
5.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i gurëve skajor C30/37 ($T>5.0 \text{ N/mm}^2$) të përhimet në bazen e betonit, dim 10/20, punimi i fugave me llaq te cimentos 1:2. Menyra e vendosjes se tyre caktohet nga organi mbikqyres.	m'	1.00	9	0.18	2
5.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i rigollave të betonit me gjersi të ndryshme ,trashesi $t=10\text{cm}$ C30/37 ($T>5.0$ në bazën e betonit C25/30, punimi i fugave me llaq te cimentos 1:2.	m'	1.00	14	0.07	0.5
5.4	Punimi dhe montimi i parmakëve të rampave shkallëve të jashtme dhe terasave në hyrje të Objektit rampave për hendihek dhe rampave për intervenimë. Parmakët me profile rrethore , mbështetëja dhe shtyllat të inkastruime në pllakë, e punuar në lartësi $h= 90 \text{ cm}$ prej profileve metalike!. Horizontalja në formë rrethore me diametër 5 cm. Vertikalet me forme dhe diametër si mbështetëja. Parmakët të punohen sipas detalit arkitektonik.	m'	1.00	200	2.00	1
5.5	Furnizimi, punimi dhe montimi i gardhit sigurues per këmbesore . Gardhi punohet me shtylla vertikale me diameter $\varnothing 90\text{mm}$ me trashesi te murit $t=3\text{mm}$, ne distance qdo 2.0 m gjatesi dhe lartesi $h=1.1 \text{ m}$, pjesa e sipërme horizontale punohet me tub qeliku me diameter $\varnothing 90\text{mm}$ me trashesi te murit $t=3\text{mm}$, mbushja punohet me tre tuba horizontal paralel ne distanca proporcjonale me diameter $\varnothing 63 \text{ mm}$ me trashesi te murit $t=2.5 \text{ mm}$, ankerimi behet me pllake çeliku $t= 8\text{mm}$ me 4 bulona metalik M 24 (sipas detalit te dhene) ne rastet ku ska mundesi shtangimi te behet betonimi i shtylles vertikal. Ne kete parashitet pastrimi i profileve, saldimi, ngjyra baze kunder korezonit si dha ngjyrosja me ngjyre yndyrote ne dy shtresa, ngjyra caktohet nga organi mbikqyres.	m'	1.00	85	0.85	1
5.6	Gryerja e ngjyrës së dëmtuar, ngjyrosja e parmakëve të metalit me një shtresa ngjyrë bazë dhe me dy shtresa ngjyrë vajore	m ²	1.00	10	0.01	0.1
5.7	Ngjyrosja e pjesëve të drurit të elementeve mikrourbane, ulëseve, reklamave dhic shportave të mbeturinave. Ngjyra duhet të jetë me qëndrueshmëri ndaj ndikimeve atmosferike si dhe përmbrrojtje nga insektet. Ngjyrosja duhet të behet në dy shtresa, nuanca ngjyrë gështenje.	copë	1.00	20	0.20	1
5.80	Furnizimi dhe montimi i pahise elastike njefishë sipas rregullave teknike per sigurimin e këmbesorve dhe automjeteve. (sipas detalit te dhene).	m'	1.00	25	0.50	2
5.90	Furnizimi dhe montimi i pahise elastike dyfishë sipas rregullave teknike per sigurimin e këmbesorve dhe automjeteve. (sipas detalit te dhene).	m'	1.00	35	0.70	2
5.10	Furnizimi me material si dhe shtrimi me gjeotekstili , në nënbasen e dheut të nivelizuar dhe ngjeshur.	m ²	1.00	3.0 €	0.01	0.4
	Gjithesejt				4.80	12
VI	PUNIMET E UJËMBLEDHSAVE,KAPAKËVË, DHE SHENJAVE TE TRAFIKUT					



6.1	Furnizimi dhe montimi i ujembledhsave komplet të tipit T ₁ , prej materiali kompozit te tipit UC GGS 3464, Klasa B 125/C250/D400. Në çmim të llogaritet materiali dhe puna komplet.	copë	1.00	140	1.40	1
6.2	Ngritura e kapakeve dhe kornizës ekzistuese në nivelin e duhur. Në çmim duhet llogaritur komplet materiali për ngritje dhë puna. Pumekryesi eshte i obliguar që pas ngritjes së kapakeve te beje pastrimin e kanalizimit fëkal apo atmosferik varsi si ne cilin rjet eshte intervenuar	Copë	1.00	60	1.20	2
6.3	Furnizimi, transporti, montimi i dhë betonimi i kapakeve prëgjize. Kapaket duhet te jene per peshë te renda 40 ton, kapaku duhet te jetë i lidhur per kornize, ne menyre qe gjate kalimit te peshave mbi kapak te mos largohet osa rrrotullohet, per te mos ardhë deri te rreziku i lendimit te njerezve dhe demtimi i automjeteve gjate levizjes. Në çmim duhet llogaritur edhe betonimi i kurores prej betonarmes C25/30.	Copë	1.00	160	1.60	1
6.4	I punon i grilave tērthore me dim. te mbrojtshme te përejës tērthore 40x50cm.Grlfat tērthore duhet te punohen prej profileve metalike.Korniza përmes sheshit e grilës punohet me L profile me dim.të profilit 50x50x5mm e cila ankerohet në muret e betonit.Korniza e grilës punohet me L profile me dim.të profilit 40x40x5mm,shufrat tērthore me dim. te përejës tērthore 40x10mm(te plota) te salduara përmes shufave b=15mm.Gjërsia e grilës duhet te jetë b=60cm.Në çmim të kalkuloohen furnizimet dhe punët përmes shufave -përja e betonit të armuar me trashësi t=25cm,gërmimi në thellësi deri 80cm dhe transporti i dhet, betonimi i mureve dhe plakës prej betoni të annuar C25/30 me trashësi t=20cm, armatura 60kg/m ³ , 1m gyp betoni Ø500mm,2m gyp Pvc Ø250mm prej grilës deri në pushtë,ngjyrosja e grilës me rruja e basa, ilba, muzaka, undha...	m'	1.00	150	1.50	1
6.5	Pregaditja e puneve paraprake per ngritjen e kapakeve te pushtave ne vendet ku kemi ulje te pushtave. Kjo nenkupton: prejjen e asfaltit rreth pushtes ne form katore 160cm x 160 cm, deri ne bazen e shenoshe, largimin e materialit te demoluar, furnizimin dhe mbushjen me zhavor (0-31)mm, ngjeshjen rreth perimetrit te konusit, si dhe vendosjen e betonit te lëshesë C 16/20 me trashesi 20cm ne tere sipërfaqen jashtë konusit, ne menyre qe plaka e parapregadit te vendoset ne koten e parapare.	Copë	1.00	100	1.00	1
6.6	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar Ø250 mm (PVC) në vendet e nevojshme të caktuara nga organi mbikqyrës.	m'	1.00	6	0.06	1
6.7	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar Ø315 mm (PVC) në vendet e nevojshme të caktuara nga organi mbikqyrës.	m'	1.00	12	0.24	2
6.8	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar 400 mm (PVC) në vendet e nevojshme të caktuara nga organi mbikqyrës.	m'	1.00	18	0.36	2
6.9	Furnizimi transporti dhë montimi i tubave (përmes pushtes) prej betonit të armuar Ø1000/1000 mm (elemente të parafabrikuara).	copë	1.00	35	0.70	2
6.10	Furnizimi transporti dhe montimi i konuseve përmes pushtes prej betonit Ø1000/700/600 mm (elemente të parafabrikuara).	copë	1.00	20	0.40	2
6.11	Hapja/zbullojimi i rrjetit të kanalizimit në hapësirat që përfshijnë sipërfaqen nga pushtë më e afërt me objektin deri tek kyqja në rrjetin primar të kanalizimit.	m'	1.00	5	0.05	1
6.12	Pastrimi/zbullojimi i pushtes së kanalizimit nga materiali i grumbulluar, imbeturinë.	m ³	1.00	25	0.25	1
6.13	Ngritura e ujembledhsave ekzistuese komplet me kornizë. Në çmim duhet llogaritur materialin komplet përmes ngritje dhë puna. Pumekryesi eshte i obliguar që pas kryerjes se punimeve te bej pastrimin e pjeses sekondare te kanalizimit atmosferik deri te kyqja me pushten kryesore.	Copë	1.00	40	0.40	1
6.14	Inçizimet gjedezike nga inxhinieri gjedet ku përfshihen matja e rrjetit të kanalizimit fëkal&atmosferik, rrethojave dhe pozicioneve tjera që maten më m' sipas kërkeshës së organit mbikqyrës në pjesët ku kemi intervencimë.	m'	1.00	10	0.10	1
Gjithesejt					9.26	19



PRODHUES DHE
PAPENBURG & ADRIANI
COMPANY SHPK.
Gjatë e vjetër
LIPJAN 7

RE KAPITULIMI			
I	Punët përgatitore	0.75	1.5
II	Punët e dheut dhe të demolimeve	3.53	14.9
III	Punët e riparimeve me asfalt	8.15	41.1
IV	Punët e tamponit – riparimeve me pilaka të betonit	5.28	11.5
V	Punët e skajoreve dhe gardhit sigurues për këmbësor	4.80	12
VI	Punët e ujembledhsave, kapakeve dhe shenjave të trafikut	9.26	19
Gjithsej:		31.76	100

A handwritten signature is written over a circular company stamp. The stamp contains the following text:
 D. NOETIMORE PRODHUSSA DHE
 PAPENBURGLADRLANI
 COMPANY SHPK.
 Grockë e vjetër
 7
 LIPJAN * 1990

0045014



SCARDIAN

SIGURIME

NUMRI I POLICES

045014

SIGURUESI

K.S. SCARDIAN J.S.C

Adresa:

Rr. Perandori Justinian 3, 10000 Prishtine,
Kosovo**AGJENTI**

Arbenita Dërvishi

Adresa:

Fsh.Koretin, Kamenice

I SIGURUARIK.N.P.SH. PAPENBURG & ADRIANI
COMPANY SH.P.K.

Adresa:

Grackë e Vjetër, Magjistrale M- 25 Ibrahim
Rugova , Pn

810652942

null

Garanci e Kontratës

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINESINTERVENIME INFRASTRUKTURORE
NË TERRITORIN E KOMUNËS SË
PRISHTINËS - LOT 6

616-22-10564-5-1-1

Republika e Kosovës

397 ditë

90,000.00 EURO

31-07-2023

31-08-2024

1755.00

315.90

2070.90

2023-07-31 09:32:48

TITULLI I KONTRATËS**NUMRI I IDENTIFIKIMIT-PROKURIMIT****TERRITORI I MBULIMIT****PERIUDHA E SIGURIMIT****SHUMA E SIGUARAR**

Nga:

Deri:

PRIMI I SIGURIMIT**TVSH 18 %****PRIMI +TVSH 18%****DATA E LËSHIMIT****VËREJTJE:**

Polica e sigurimit të Garancive është krijuar në bazë të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 10.05.2012, gjithashtu sipas Rregullave dhe Rregulloreve të Aprovuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Pjesë përbërëse e kësaj police janë Kushtet e përgjithshme, pyetësori, i plotësuar dhe të nënshkruar dhe çfarëdo dokumenti tjetër i bashkangjitur me më rrethën e sigurimit.

Kjo poloci sigurimi vërteton lidhjen e kontratës, dhe lëshohet nga Siguruesi në bazë të detyrimeve dhe kërkesave të bëra nga i Siguruar/përfaqësuesi i të siguruarit, i cili është përgjegjës lidhur me saktësinë e vërtetësinë e deklarimeve të bëra prej tij.

Unë i Siguruar/ përfaqësues i të siguruarit, deklaroj se i kam lexuar me vëmendje që i kam kuptuar kushtet e kontratës së sigurimit, deklaroj se po joftohem më to, si dhe me të dhërat e përcaktuara e kësaj police siuimi, dhe po nënshkrui konform vullnetit tim të lirë, e të plotë.

I SIGURUARI

(emri, mbiemri, nënshkrimi)



SCARDIAN

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

Pjesë përbërëse e policës: 045014

Për: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

Në emër të: K.N.P.SH. PAPENBURG & ADRIANI COMPANY SH.P.K., Grackë e Vjetër, Magjistrale M- 25
Ibrahim Rugova , Pn
(në vazhdim "tenderuesi")

VËREJTJE:

Titulli i aktivitetit të prokurimit: INTERVENIME INFRASTRUKTURORE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PRISHTINËS- LOT 6

Numri i prokurimit: 616-22-10564-5-1-1

SIGURIA E KONTRATËS

Garacion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartçekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **90,000.00 EURO (NENTEDHJETE MIJE EURO)** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përbushja e njërit nga kushtet në vijim:

(a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancialë dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe

(b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **90,000.00 EURO** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen 397 ditë
Data e fillimit: 31-07-2023

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit:

SCARDIAN Sigurime
Rr. Perandori Justinian Nr.3
10000 Prishtinë
Kosovë
2023-07-31 09:32:48

